



P Z A P  
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.126/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Skender Çoçaj dhe Kymete Kicaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhje Lokale 2025, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.10.2025, merr këtë:

#### V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, ZL.Anr.126/2025 e datës 07.10.2025.

II. Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbëshitetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënim i gjelbëri më gjelbëri në lartësi prej 3,000.00€ (tre mijë euro).

III. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (Kandidati Hysni Mehanaj), që gjelbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

IV. Urdhërohet kandidati Hysni Mehanaj nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, që nga momenti i marjes së këtij vendimi ta largojë postimin e datës 05.10.2025, të bëre në profilin e tij ne rrjetin social Facebook, përndryshe mosbindja ndaj kësaj urdhërese paraqet shkelje tjeter të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënimë shtesë nga PZAP-i.

#### A r s y e t i m

Me datë 07.10.2025, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se më datë 05.10.2025, kandidati për Kryetar të Skenderajt, Hysni Mehanaj, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, në rrjetin social Facebook, ka postuar një shkrim që përmban gjuhë fyese dhe nxitje të urrejtjes ndaj kandidatit të PDK-së për kryetar të kësaj Komune, Sami Lushtaku, ku ndër të tjera ka përdorur shprehjet si: “*demagog*”, “*përçarës i llojit të vet*”, “*tuc i llojit të vet*”, dhe e akuzon si kriminel duke u referuar me fjalinë “*krimet që ka bërë me pronat e Skenderajt*”, duke shtuar se këto shprehje jo vetëm që përbejnë fyerje personale, dhe politike, por përbejnë edhe elemente të

partë të gjuhës së urrejtjes, të cilat mund të konsiderohen si nxitje ndaj dhunës dhe përçarje mes qytetarëve, duke theksuar se këto deklarime janë veçanërisht shqetësuese duke pasur parasysh se vijnë nga kandidat për një funksion publik i cili duhet të shërbej si shembull i përgjegjshmërisë dhe respekti ndaj kundërshtarëve politikë. Me këtë sipas parashtruesit të ankesës është bërë shkelje e rëndë e Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, respektivisht nenit 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11.

Si provë ka bashkëngjitur fotografinë e postimit nga llogaria sociale Facebook e kandidatit për kryetar Hysni Mehanaj.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje ka kundërshtuar pretendimet e parashtruesit të ankesë duke shtuar se publikimi i Hysni Mehanaj është përgjigje ndaj një deklarate të bërë nga Sami Lushtaku ditë më parë e cila përbante cilësimet dhe akuza ndaj qeverisjes se Lëvizja Vetëvendosje, dhe që i etiketon kundërshtarët politik si demagog dhe ata që sollën përçarje e sanksione ndërkombëtare. Tutje, në përgjigje në ankesë theksohet se postimi i Hysni Mehanaj është reagim politik, dhe si i tillë bie brenda përbën shprehje të lire politike, nuk përmban thirrje për dhunë, dhe as nxitje për urrejtje, përkundrazi përfaqëson shprehje të bindjeve politike dhe qëndrueshmërisë personale të kandidatit. Tutje kanë shtuar se ligji e kufizon vetëm gjuhën që nxit dhunë dhe urrejtje, jo kritika të forta politike, duke shtuar se shprehjet “demagog”, “përçarës”, dhe “tuc”, janë tipike të fjalorit politik të debatit zgjedhor dhe nuk përbëjnë nxitje të urrejtjes apo dhunës, ndonëse me tone të forta mbetet brenda kufijve të shprehjes së lirë politike.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa-PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

- *Ankesa është e bazuar*

Paneli, pas vlerësimit të shkresave të ofruara si provë materiale në ankesë, si dhe përgjigjes në ankesë paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, vëren se kandidati për kryetar të Skenderajt nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje Hysni Mehanaj, përmes llogarisë së tij në rrjetin social Facebook ka përdorur shprehjet si “*demagog*”, “*përçarës i llojit të vet*”, “*tuc i llojit të vet*”, duke iu drejtuar kështu kandidatit të PDK-së për kryetar të Komunës së Skenderaj, Sami Lushtaku, vëren se e njëjtë është e bazuar, sepse përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1, pika 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet, “*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalojen nga bërja e ndonjërisë si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografji, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*”. Prandaj për Panelin një veprim i tillë i subjektit politik në fjalë është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura.

Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit

të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politike të janë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Andaj, Paneli vëren se gjuha e përdorur në rrjetin social Facebook, nga kandidati i subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje Hysni Mehanaj, ndaj kandidatit për kryetar te Komunës së Skenderajt nga subjekti politik të PDK-së, Sami Lushtaku në fushatë zgjedhore, dhe përdorimi i termave “*ideolog i hajnisë dhe zhvatjes*” dhe “*krimet që ka bërë me pronat e Skenderajt*”, janë në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike përkatësisht, neni 34 paragrafi 1, pika 1.11, të LZP-së, prandaj, për panelin një veprim i tillë i subjektit politik në fjalë është në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara.

Në këtë rast është marrë për bazë konteksti dhe qëllimi përfshirë cilin është dhënë deklarata në rrjetin social Facebook, prandaj, sipas Panelit, përdorimi i gjuhës së tillë ka përfshirë qëllim nxitje të urrejtjes. Sipas vlerësimit të Panelit, rregullat që rregullojnë fushatën zgjedhore kërkojnë nga subjektit politike dhe përfaqësuesit e tyre të shmangin përdorimin e gjuhës fyeze, denigruese dhe urrejtëse. Përdorimi i kësaj gjuhe nga kandidati përfshirë kryetar të Komunës se Skenderajt Hysni Mehanaj, nga subjekti politik LVV, sipas Panelit është shkelje e etikës zgjedhore dhe standardeve të sjelljes në fushatë zgjedhore. Sjellja e tillë minon procesin demokratik dhe promovimin e zgjedhjeve të lira e të drejta. Fushatat zgjedhore duhet të zhvillohen në një ambient të ndershëm dhe të drejtë, duke respektuar të drejtat dhe dinjitetin e të gjithë qytetarëve dhe grupeve shoqërore. Shprehjet që janë përdorur mund të krijojnë një atmosferë të pasigurt, duke shkelur kështu parimet e një fushatë pozitive dhe të respektueshme.

PZAP-i me rastin e shqiptimit të gjobës ka marrë përfshirë bazë kontekstin se deklarata është bërë në kohën e fushatës zgjedhore dhe se nxit dhunë dhe urrejtje politike.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrëthanat si në vijim : natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes. Kjo konsiston në atë se subjekti politik LVV ka qenë i njofuar me obligimet dhe përgjegjësitë gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ndaj subjektit politik LVV si masë lehtësuese ka marrë përfshirë faktin se ky subjekt me parë nuk është dënuar përfshirë përdorim të gjuhës së urrejtjes me parë gjatë kësaj fushatë zgjedhore.

Nga arsyet e theksuara me lartë, e në kuptim të nenit 33 par. 5, nenit 34 par.1 pika 1.1, neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të Ligji Nr.08/L-228 përfshirë Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor përfshirë Ankesa dhe Parashtresa  
ZL.Anr.126/2025, datë 10.10.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 paragrafi, 4 të LZP-së.